



## RELACION

### PËR

### **MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020**

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ndryshuar; ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe në udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë së Tiranës është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, bazuar në funksionet e pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar ndryshuar si dhe në udhëzimin nr.7 datë 27.02.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Buxhetit Vendor” dhe udhëzimit plotësues nr. 20 datë 10.07.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Buxhetit Vendor”, në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia e Tiranës. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program buxhetor.

Si pasojë e gjëndjes së emergjencës shkaktuar nga rënia e tërmetit e datës 26 nëntor 2019, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për tre qytete në vend, përfshirë edhe qytetin e Tiranës, duke cënuar sigurinë dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar.

Ndodhur në këto kushte, Bashkia e Tiranës nuk mundi të dorëzojë në Këshillin Bashkiak draft projekt-vendimin për miratimin e PBA 2020-2022 brënda afateve të caktuara në ligj, datës 29 Nëntor 2019 pasi vijoi nismën e marrjes së masave për akordimin e fondeve të nevojshme në emergjencat civile duke ndryshuar buxhetin e vitit 2019 dhe duke riparë zërat kryesore si dhe fondin e emergjencës në PBA 2020-2022.

#### **Prioritetet e buxhetit afatmesëm:**

Programet Buxhetore të katër viteve të shkuara kanë arritur tashmë objektivat e rikthimit të Tiranës në punë. Kanë përfunduar disa nga projektet e mëdha strategjike; është ndërhyrë në pjesën dërrmuese të lagjeve të qytetit me projekte rigjenerimi urban; është siguruar pastërtia e qytetit dhe reduktuar ndotja; është shtuar sipërfaqja e gjelbër; është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në të gjithë çerdhet e kopshtet e qytetit; janë krijuar hapësira të reja rekreative; është rigjallëruar jeta kulturore dhe masivizimi i sporteve.

Objektivi themelor i PBA-së 2020-2022 do të jetë garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të Tiranës, për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm e për të garantuar mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Hartimi i buxhetit të ardhshëm mbështetet në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë, në të cilën janë parashikuar 5 qëllimet kryesore të zhvillimit, të zërthyera në disa objektiva specifike:

1. Përmirësimi i infrastrukturës urbane;
  - Rehabilitimi dhe mobilimi urban i njësive
  - Përmirësimi i rrjetit rrugor urban, me fokus të posaçme tek korsite e bicikletave dhe trotualet.
  - Përmirësimi i hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndricim etj
  - Krijimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës e rrjeteve inxhinjerie,
2. Arsimi për të gjithë
  - Ndërtimi i shkollave të reja
  - Përmirësimi i infrastrukturës në objektet arsimore;
  - Rritja e sigurisë në rrugë e në objektet shkollore;
3. Zhvillimi i Ekonomisë Green
  - Nxitja e zhvillimit rural dhe turizmit dhe ndihmesë bujqësisë.
  - Nxitja e zhvillimit ekonomik, punësimit e sipërmarrjes;
  - Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit
4. Tirana për të gjithë
  - Nxitjen e mobilitetit alternativ dhe të qëndrueshëm për rritjen e aksesueshmërisë
  - Përmirësimi i transportit publik duke futur dhe teknologjitë e reja
  - Rritjen e kapacitetit të parkimit në qytet dhe përdorimin efiçent të hapësirave ekzistuese
  - Përmirësimin e shërbimit të varrezave publike
  - Ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, etj
  - Rritjes së sipërfaqeve të gjelbra e parqeve dhe shtimit të hapësirave rekreacionale;
  - Nxitjes së jetës kulturore e sportive në qytet;
  - Mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes,
  - Mbeshtetje politikave rinore dhe zhvillimit të karrieres,
5. Qeverisja e mirë
  - Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarit dhe biznesit
  - Rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve në vendimmarrje
  - Administrimin më të mirë të të ardhurave të Bashkisë
6. Projektet e reja strategjike
  - Piramida,
  - Kopshti Zoologjik,
  - Tirana Policentrike,
  - Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik- Teda,
  - Kampusi Universitar,
  - Pylli Orbital,

- Teatri Kombetar,
- Zgjerimi i Lumit Lana,
- Axhenda E Gjellbër E Qytetit,
- Rruga e Arbërit
- Unazat e Tiranës

Ndërhyrjet kryesore në infrastrukturën e qytetit do të realizohen në programet kryesore:

## **1. Transporti**

Investimet brenda këtij programi do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e infrastrukturës rrugore, duke vijuar me aplikimin e standardeve më të larta në gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe do të përbëjnë 34% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020 – 2022.

Gjatë vitit 2020 do të ndërhyhet me sistemim asfaltim të infrastrukturës rrugore, rikonstruksione, ndërtime të rrugëve të reja së bashku me rrjetet inxhinierike.

Modernizimi i transportit publik është gjithashtu, një prioritet i rëndësishëm i cili do të testohet nëpërmjet biletimit elektronik. Për të reduktuar trafikun do të kryhet transferimi i linjave të transportit ndërqytetas dhe ndërkombëtar jashtë unazës së mesme, deri në ndërtimin e terminaleve të udhëtarëve.

## **3. Arsimi bazë dhe parashkollor/Arsimi parauniversitar**

Duke qenë se Bashkia e Tiranës ka nisur skemën e një të partneritetit publik privat për ndërtimin e 17 shkollave të reja, në programin e arsimit parauniversitar janë parashikuar investime të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore si dhe ambjenteve ndihmëse e rekreative të objekteve arsimore. Me ndërtimin e 10 shkollave të reja 9-vjeçare dhe 7 shkollave të reja të mesme, në qytetin e Tiranës do të marrë fund njëherë e përgjithmonë problemi i mësimin me dy turne. Përmes partneritetit publik privat, shkollat e reja do të ndërtohen me financimin e koncensionarit dhe Bashkia Tiranë do t'i paguajë me këste vjetore për një periudhë 7 vjeçare me anë të të ardhurave të mbledhura nga Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Pjesë e projekteve të këtij programi janë edhe objektet arsimore parashkollor dhe parauniversitare ekzistente të cilat kërkojnë rikonstruksione, shtesa katesh etj.

Investimet në këtë program do të përbëjnë 17% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022.

Programi ka të parashikuar si objektiv edhe shfrytëzimin e infrastrukturës së objekteve të arsimit parauniversitar pas përfundimit të procesit të mësimin në dobi të nxënësve dhe komunitetit, por edhe mbështetje duke dizenuar dhe aplikuar projekte social-arsimore që ndikojnë dukshëm në edukimin e fëmijëve.

## **4. Zhvillimi i komunitetit (Programet e zhvillimit dhe Shërbimet publike vendore)**

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në blloqet e banimit do të përbëjnë 24% të buxhetit të investimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022.

Rehabilitimi i hapësirave publike, shtimi i gjelbërimit në të gjithë territorin e qytetit, krijimi i hapësirave të reja rekreative, rikualifikimi i rrjetit ekzistues të ndriçimit deri në 100% dhe sigurimi i ndriçimit për hapësirat e reja urbane, janë objektivat parësorë të këtij programi për 3 vitet e ardhshme.

## **5. Familje dhe fëmijët / Papunësia / Strehimi**

Parashikimi i buxhetit social, adreson objektivat zhvillimore të Bashkisë Tiranë në fushën sociale, që lidhen drejtpërsëdrejti me zbutjen e varferisë dhe zhvillim ekonomik të shtresave të caktuara. Në ndarjen e zërave të këtij buxheti, disa prej tyre vijnë në rritje si: programet e strehimit social e nxitjes së punësimit, skema të cilat synojnë zhvillim afatgjatë, e disa zëra janë risi buxhetimi sic është fondi social per OJF”, projekte këto që ndikojnë drejtpërsëdrejti në nivelin e mirëqënies së qytetarëve tanë. Koherenca e buxhetimit social në përputhje me nevojat e vlerësuara është qëllimi i programit të kujdesit social.

Është mision yni që t'i sigurojë çdo qytetari të Tiranës, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Shërbimet e parandalimit, ndërhyrjes, mbrojtjes dhe riintegritimit të fëmijëve e familjeve të tyre në rrjedhën normale të jetës social-ekonomike, kjo përmes shërbimeve me bazë komunitare, veçanërisht për fëmijët në situatë rruge, është një nga objektivat madhorë të këtij programi.

Si pasojë e gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, në zbatim të vendimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” si dhe në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen civile”, bonusi i strehimit është një nga zërat që zë peshën më të madhe buxhetore në këtë program.

### **Politikat e hartimit të buxhetit:**

Buxheti afatmesëm është hartuar bazuar në:

- Garantimin e qëndrueshmërisë financiare dhe efikasitetit në menaxhimin e financave të qytetit;
- Planifikim afatmesëm deri në afatgjatë bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm të qytetit, duke garantuar një instrument efikas të integritimit të objektivave politike në procesin buxhetor;
- Përfshirjen qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje;
- Marrjen e masave për mbulimin buxhetor të nevojave të emergjencës së shkaktuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019

### **Parashikimi i të ardhurave**

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Tiranës mbështetet në politikat fiskale të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë së Tiranës. Për periudhën 2020-2022 janë propozuar ndryshime në tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, në masën e një indeksimi të arsyeshëm për të mbuluar deri në një masë të caktuar kostot e dyfishuara të ofrimit të shërbimit si dhe një ndryshim në taksën e

përkohshme për infrastrukturën arsimore për të ekuilibruar ngarkesën fiskale të biznesit të vogël më xhiro 0-2 milionë lekë.

Niveli i të ardhurave të planifikuara është mbështetur, në politikat e reja, kapacitetin ekzistues të taksave e tarifave vendore sipas informacionit të përfituar nga programi i taksave vendore, ecurinë e realizimit të tyre në vitet e mëparshme si dhe në vlerësime mbi zhvillimet e mundshme ekonomike dhe urbane etj. për periudhën 3 vjeçare, me supozimin që politikat fiskale do të mbeten të pandryshuara për periudhën.

Parashikimi i të ardhurave dhe supozimet përkatëse bazohen në:

- Rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave në kufijtë e kapacitetit;
- Përmirësimin e kushteve të biznesit dhe thjeshtimin e procedurave tatimore;
- Forcimin e administratës tatimore vendore;

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në lekë*

Lloji i të ardhurave	Plan 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021	Parashikimi 2021
Të ardhura të taksueshme	8,972,750,000	10,017,826,000	9,420,602,000	9,428,304,200
Të ardhura jo tatimore	4,386,280,000	4,606,420,000	4,708,187,000	4,792,903,000
<b>Total të ardhura</b>	<b>13,359,030,000</b>	<b>14,624,246,000</b>	<b>14,128,789,000</b>	<b>14,221,207,200</b>
Transferta e pakushtezuar e përgjithshme	2,348,723,419	2,424,942,357	2,740,160,004	2,927,708,309
Transferta e pakushtezuar sektoriale	1,159,433,601	1,176,039,602	1,250,000,000	1,300,000,000
<b>Total Transferta</b>	<b>3,508,157,020</b>	<b>3,600,981,959</b>	<b>3,990,160,004</b>	<b>4,227,708,309</b>
Te ardhura te mbartura	1,500,000,000	2,100,000,000	0	0
<b>Totali</b>	<b>18,367,187,020</b>	<b>20,325,227,959</b>	<b>18,118,949,004</b>	<b>18,448,915,509</b>

### Parashikimi i shpenzimeve

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njërive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes),
- Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- Institucionet e varësisë

Për periudhën afatmesme, politikat e pagave janë supozuar të pandryshuara. Shpenzimet korente janë rritur me 15% ndërsa shpenzimet kapitale nuk kanë rritje të ndjeshme.

Shpenzimet e Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme

*Në lekë*

Funksioni	Plan 2019	Plan 2020	% ne strukturë	Plan 2021	Plan 2022
1 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme	2,638,295,743	2,846,067,330	14%	2,926,417,276	2,877,235,336
2 Shërbime të huamarrjes vendore	150,000,000	338,767,306	2%	351,336,960	341,497,723
3 Shërbime policore	425,923,471	470,482,000	2%	465,982,000	466,782,000
4 Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	186,137,227	619,632,940	3%	303,472,590	243,359,417
5 Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës	110,109,650	174,950,106	1%	116,045,660	111,393,240
6 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	329,931,403	392,724,796	2%	276,911,976	267,807,976
7 Transporti	3,558,507,146	3,435,624,989	17%	2,430,967,294	2,174,877,005
8 Industri të tjera	15,000,000	50,215,947	0%	15,000,000	6,600,000
9 Menaxhimi i mbetjeve	1,553,226,458	1,925,564,551	9%	2,027,691,071	2,027,691,071
10 Urbanistika	949,646,391	1,475,995,950	7%	1,418,942,935	1,120,904,086
11 Zhvillimi i komunitetit	3,204,231,368	3,060,187,356	15%	2,673,759,807	2,821,644,654
12 Ndriçimi i rrugëve	240,000,000	310,000,000	2%	264,000,000	316,800,000
13 Shërbimet rekreative dhe sportive	279,239,193	294,548,575	1%	243,378,000	250,005,800
14 Shërbimet kulturore	342,257,664	426,440,470	2%	319,548,000	319,438,000
15 Arsimit bazë dhe parashkollor	2,975,211,102	2,628,616,342	13%	1,983,837,195	1,980,202,750
16 Arsimit parauniversitar	932,800,474	1,274,600,304	6%	1,816,253,920	2,637,792,131
17 Sëmundje dhe paaftësi	15,671,400	15,600,000	0%	15,600,000	15,600,000
18 Familje dhe fëmijët	212,346,187	238,130,720	1%	209,804,320	209,284,320
19 Papunësia	25,000,000	25,000,000	0%	25,000,000	25,000,000
20 Strehimi	83,652,142	132,078,277	1%	45,000,000	45,000,000
21 Fondi rezerve	120,000,000	150,000,000	1%	150,000,000	150,000,000
22 Fondi I Kontigjences	20,000,000	40,000,000	0%	40,000,000	40,000,000
<b>TOTALI</b>	<b>18,367,187,020</b>	<b>20,325,227,959</b>	<b>100%</b>	<b>18,118,949,004</b>	<b>18,448,915,509</b>

Informacion më të zgjeruar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe projektet e PBA 2020-2022, do ta gjeni në materialin e plotë shoqëruës.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Me respekt,

**Znj. Eni Memishahi,**

Specialiste, Sektori i Planifikimit të Buxhetit

**Znj. Drilona Aliko**

Specialiste, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

**Znj. Elida Kafia**

Specialiste, Sektori i Planifikimit të Buxhetit

**Znj. Besjana Andoni**

Përgjegjës, Sektori i Planifikimit të Buxhetit

**Znj. Arba Isaj**

Përgjegjës, Sektori i Zbatimit të Buxhetit

**Znj. Jonida Rudaj**

Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

**Znj. Edlira Koço**

Drejtore, Drejtoria e Monitorimit të Taksave dhe Tarifave Vendore

**Znj. Ermira Mara**

Drejtore, Drejtoria e Buxhetit

**Znj. Laura Deliu**

Drejtore, Drejtoria Juridike

**Znj. Jonida Halili**

Drejtore i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar

**Z. Alban Dokushi**

Drejtore i Përgjithshëm Juridik i Aseteve dhe Licensimit

**Z. Ermir Puka**

Drejtore i Përgjithshëm i e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave

**Z. Taulant Tusha**

Drejtore i Përgjithshëm i Punëve Publike

**Znj. Julinda Dhame**

Drejtore i Përgjithshëm i Promovimit të Qytetit

**Z. Genc Kojdheli**

Drejtore i Përgjithshëm i Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik

**Z. Ditjon Baboçi**

Drejtore i Përgjithshëm i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

**Znj. Enkelejda Omeri**

Drejtore i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore

**Z. Enio Minxhozi**

Drejtore i Përgjithshëm i Komanduar i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

**Znj. Anisa Subashi**

Drejtore i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale

**Z. Erindi Bejko**

Drejtore i Përgjithshëm i Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile

**Z. Arli Naska**

Drejtore i Përgjithshëm i Taksave dhe Tarifave Vendore

Arbjan Mazniku

**Zv. Kryetar**

**Esmeralda Demiraj**

Juristi i Këshillit Bashkiak

**Behar Zeneli**

Sekretar i Këshillit Bashkiak